



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 10 mars 2010, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Kolë Berisha, Dzezair Murati, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Ahmet Isufi, Suzan Novobrdaliu, Besa Gaxherri dhe Vladimir Todorovic.

Pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati NDI, Rrezarta Ahmeti KDI, Artan Venhari KIPRED dhe Floriana Shala OSBE.

Të pranishëm nga Departamenti për çështje ligjore dhe procedurale: Daut Beqiri, Xheladin Hoxha dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni - Kaloshi - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 4 shkurt 2010;**
- 3. Procedimi i Draft-rregullores së Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 4 shkurt 2010, u miratua njëzëri pa vërejtje.

3. Procedimi i Projekt-rregullores së Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare

Hydajet Hyseni - njoftoj anëtarët e komisionit se grupi punues ka bërë rishikimin dhe lekturimin e tekstit të Projekt-rregullores së Kuvendit si dhe me propozimin për fushëveprimin e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Lidhur me Projekt-rregulloren e Kuvendit dhe fushëveprimin e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, diskutuan: Besa Gaxherri, Hydajet Hyseni, Ahmet Isufi, Suzan Novoberdaliu, dhe Ramadan Gashi.

Komisioni, pas shqyrtimit nën për nen të Projekt-rregullores së Kuvendi dhe fushëveprimit të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të miratojë Projekt-rregulloren e Kuvendit me amendamentet e propozuara dhe të përkrahura nga Komisioni Funkcional.
2. Fushëveprimi i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, inkorporohet në shtojcën 2 të Projekt-rregullores së Kuvendit.
3. Projekt-rregullorja e Kuvendit me amendamentet e propozuara, të dërgohet për përkthim dhe lekturim në gjuhen serbe.

Mbledhja përfundoi në orën 12.15.

E hartoi:

Njësia për mbështetje të Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Hydajet Hyseni –Kaloshi